



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË / MINISTARSTVO ZDRAVSTVA / MINISTRY OF HEALTH

PLANI I VEPRIMIT

2011-2014

PËR STRATEGJINË SEKTORIALE TË SHËNDETËSISË

2010 - 2014

Dhjetor 2010 / Plotësuar në Mars 2011

1. PËRMBAJTJA

1. PËRMBAJTJA	2
2. LISTA E SHKURTESAVE	3
3. FALËNDERIMET.....	6
4. HYRJE.....	7
4.1. Qëllimi i Planit të Veprimit.....	7
4.2. Sfida kryesore e sektorit shëndetësor	8
4.3. FUSHAT PRIORITARE TË VEPRIMIT	12
4.4. Kostoja.....	14
5. PJESA I: PLANI I VEPRIMIT	15
5.1. Përmbledhje e Planit të Veprimit për Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2010 - 2014	16
6. PJESA II: KOSTOJA E PLANIT TË VEPRIMIT	51
6.1. PËRMBLEDHJE E BUXHETIT	52

2. LISTA E SHKURTESAVE

AKPSH	Agjencioni Komisionar për Përkujdesje Shëndetësore
AVUK	Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit i Kosovës
AT	Asistenca Teknike
BE	Bashkimi Europian
BNJ	Burimet Njerëzore
DMS	Departamenti i Menaxhimit Strategjik
DSHSH	Departamenti Shërbimeve Shëndetësore
EKBK - UNKT	Ekipi i Kombeve të Bashkuara për Kosovë
EMF	Ekipet e Mjekësisë Familjare
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
FKBF - UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
FKBP - UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullatë
FKNS	Fushata Komunikuese për Ndryshim të Sjelljeve
FPV	Fushat Prioritare të Veprimit
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GP	Grupi Punues
HIV/AIDS	Virusi i Imunodeficiencës Humane/Sindroma e Fituar e Imuno Deficiencës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IPA	Instrumenti i Para-Anëtarësimit
KASH	Korniza Afat-mesme e Shpenzimeve
KDSH	Kujdesi Dytësor Shëndetësor
KMMF	Kolegji Mbretëror i Mjekëve Familjar
KNS-ICD	Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve
KPSH	Kujdesi Parësor Shëndetësor
KTSH	Kujdesi Tretësor Shëndetësor

LUX- DEVELOPMENT	Agjencioni i Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MP	Marrëdhëniet me Publikun
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OS	Objektivi Strategjik
OSHQ	Organizatat e Shoqërisë Civile
OZHM	Objektivat Zhvillimore të Mileniumit
PUK	Protokolet dhe Udhërrëfyesit Klinik
PKBZH - UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
PMF	Punktet e Mjekësisë Familjare
PV	Plani i Veprimit
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet European
PZHI	Plani i Zhvillimit Institucional
PZI	Programi i Zgjeruar i Imunizimit

QEVI	Qendra për Edukim të Vazhdueshëm të Infermierisë
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
QZHMF	Qendra për Zhvillimin e Mjekësisë Familjare
RH	Resurset Humane
SISH	Sistemi i Informimit Shëndetësor
SPZHK	Strategjia dhe Plani Zhvillimor i Kosovës
SR	Spitali Rajonal
SSSH	Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë
TBC	Tuberkulozi
ZHVP	Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional
ZNKE-ECLO	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit European në Kosovë

3. FALËNDERIMET

Ministria e Shëndetësisë (MSH) shpreh mirënjohje për Këshillin Profesional për angazhimin, udhëheqjen dhe shqyrtimin e Planit të Veprimit (PV), për pesë Grupet Punuese të Objektivave Strategjike të cilët kanë përpiluar komponentat strategjike specifike të PV-së, për Grupin Punues Teknik i cili ka shqyrtuar dhe strukturuar përmbajtjen e PV-së, për Grupin Punues i cili ka vlerësuar koston si dhe për Agjensionin Lux-Development i cili ka mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë gjatë tërë procesit.

Mirënjohjet i drejtohen edhe të gjitha insitucioneve dhe individëve që kanë ofruar plotësime dhe komente të rëndësishme për PV-në, në veçanti Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit European (ZNKE), Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSh), UNICEF-in, Ekipin e Kombeve të Bashkuara për Kosovën (EKBK/UNKT), si dhe donatorët tjerë që kanë ofruar mbështetje gjatë këtij procesi.

4. HYRJE

4.1. Qëllimi i Planit të Veprimit

Plani i Veprimit (PV) është pjesë përbërëse e Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë (SSSH) të Kosovës 2010-2014.

PV është dokument strategjik i cili i njofton të gjitha institucionet shëndetësore, donatorët dhe partnerët tjerë në sektorin e shëndetësisë, për prioritetet kyçe të MSH-së. Prioritetet e prezantuara në PV reflektojnë kahjet strategjike dhe mënyrat përmes së cilave institucionet shëndetësore dhe personeli i tyre do të hartojnë planet specifike për zbatimin e SSSH-së.

PV është dokument operativ që ka për qëllim detajizimin e prioriteteve strategjike, rezultateve dhe veprimeve, përmes së cilave SSSH do të ndikoj pozitivisht në zhvillimin e sistemit shëndetësor dhe të gjendjes shëndetësore të popullatës së Kosovës.

PV bazohet në parimin e plotësimit dhe përqendrohet në ndryshime. PV nuk ofron listën e plotë të asaj çfarë është duke ndodhur në sektorin shëndetësor të Kosovës, por i prezanton vetëm ato ndryshime plotësuese të cilat parashikohet se mundësojnë arritjen e qëllimeve të SSSH-së. Prandaj, të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjer më tani nga institucionet shëndetësore, programet e organizatate ndryshme dhe MSH-ja, nuk ceken në mënyrë eksplicite në PV, por konsiderohen si parakushte jetike për implementim të suksesshëm të PV-së.

PV gjithashtu paraqet një bazë solide për kordinim të donatorëve dhe është një nga komponentët kryesore të Qasjes së Gjërë Sektoriale të prezentuar rishtazi në sektorin e shëndetësisë që i mundëson MSH-së të pozicionohet si drejtues i ndryshimeve në sektorin shëndetësor, ndërsa komunitetit të donatorëve i mundëson përqendrimin e mbështetjes në prioritetet strategjike të zhvillimit të sektorit të shëndetësisë.

Ky plan bazohet poashtu në principet dhe përkushtimin e dalë nga Karta e Talinit “Sistemet shëndetësore për shëndet dhe mirëqenie” të aprovuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe shtetet anëtare të rajonit evropian në qershor të vitit 2008.

Përveç kësaj, PV është instrument për menaxhim strategjik dhe zhvillim të politikave, pasi që ofron kahje për zhvillime strukturale që kontribuojnë në reformimin e sistemit shëndetësor dhe në ndryshime të cilat tejkalojnë kufinj të mandateve politike dhe të burimeve njerëzore.

PV është dokument dinamik pasi që MSH-ja do ta përdor me kujdes atë si instrument për monitorimin e zbatimit të SSSH-së dhe si mjet të informimit lidhur me atë se çfarë është duke funksionuar mirë e çfarë jo. Andaj, parashihet që PV-ja të përditësohet rregullisht në bashkëpunim dhe kordinim të ngushtë me të gjithë partnerët e sektorit shëndetësor.

4.2. Sfida kryesore e sektorit shëndetësor

Analizat e bëra në Strategjinë Sektoriale Shëndetësore (SSSH) tregojnë që Republika e Kosovës, shteti më i ri në Europë, ka një popullatë të re dhe relativisht të shëndoshë, rrjetin e institucioneve shëndetësore të shpërndarë mirë dhe me personel profesional dhe të përkushtuar, që ofrojnë kujdes shëndetësor themelor të krahasueshëm me nivelin regjional.

SSSH-ja dhe analizat aktuale vënë në pah se Kosova si një nga shtetet më të varfëra në Europë ka nevojë të adresoj disa sfida fundamentale, para se sektori shëndetësor i saj të bëhet sistem gjithëpërfshirës i shërbimeve parandaluese, diagnostikuese dhe trajtuese që janë në pajtim me nevojat e popullatës dhe që i mbështesin qytetarët të kenë gjendje shëndetësore të krahasueshme me popujt e Bashkimit Europian.

Kosova ka popullatën më të re në Europë (50% e popullatës është nën moshën 25 vjeçare), andaj sistemi shëndetësor i Kosovës duhet të jetë në gjendje t'i përgjigjet kërkesave të larta për shërbime të shëndetit riprodhues dhe të planifikimit familjar. Edhe pse shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve ka shënuar rënie që nga viti 2000, shkalla ekzistuese prej 19,3 vdekje perinatale për 1000 lindje të gjalla¹, e vendos Kosovën në vendin e fundit krahasuar me vendet e BE-së dhe Europës. Përveç kësaj, shkalla mjaft e lartë e vdekjeve maternale prej 43.3 për 100,000 lindje të gjalla, në vitin 2009² është indikacion për nevojën e krijimit të sistemit të shërbimeve që janë në gjendje të mbështesin të gjitha femrat dhe meshkujt me shërbime të planifikimit të familjes, kujdesit antenatal cilësor dhe të siguroj që spitalet, si ato dytësore apo tretësore, të jenë në gjendje të ofrojnë kujdes adekuat në rast të komplikimeve. Prandaj, PV-ja i jep rëndësi të veçantë përmirësimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës në nivel të krahasueshëm me shtetet e BE-së dhe rrjedhimisht arritjes së Objektivave Zhvillimore të Mileniumit (OZHM).

Sëmundjet jongjitëse që ndërliken me moshën dhe stilin e jetës, janë në rritje e sipër, veçanërisht kanceri, sëmundjet kardiovaskulare dhe diabeti, pastaj sëmundjet që janë pasojë e konsumimit të lartë të duhanit, alkoolit, yndyrave, etj. Edhe pse, diagnostikimi dhe trajtimi themelor ofrohet nga sistemi publik shëndetësor i tanishëm, shërbimet gjithëpërfshirëse tretësore siç janë ato të onkologjisë dhe kardio-kirurgjisë, ende

¹ Situata perinatale në Kosovë, 2000 – 2009, Maj 2010

² ibid

nuk janë plotësisht në dispozicion. Andaj, PV-ja përqendrohet në përmirësimin e këtyre shërbimeve. Gjithashtu, PV-ja adreson zhvillimin e masave parandaluese të cilat do të kenë ndikim të madh në incidencën dhe shkallën e mbijetesës të këtyre sëmundjeve.

Përkundër angazhimeve për të zgjidhur çështjen e ndotjes së mjedisit me metale të rënda në Mitrovicë, kjo çështje mbetet si një rrezik specifik shëndetësor për tërë popullatën që jeton në atë regjion si dhe për gjeneratat e ardhshme. Siç detajizohet në PV, sistemi i kujdesit shëndetësor do të lehtësoj në mënyrë aktive adaptimin dhe zbatimin e veprimeve multi-sektoriale, që sigurojnë zgjidhjen e këtyre problemeve të shëndetit publik.

Shkalla e lartë e papunësisë, zhvillimi i ultë ekonomik në Kosovë dhe situata aktuale higjieno-sanitare i kontribuojnë klimës së pavolitshme për luftimin e sëmundjeve ngjitëse. Prandaj, PV-ja përfshinë edhe iniciativa për zvogëlimin e ngarkesës së sëmundjeve infektive në përgjithësi, me theks të veçantë në përmirësimin e parametrave socio-ekonomike me ndikim në statusin shëndetësor të popullatës.

Ofrimi i kujdesit shëndetësor cilësor ndërlidhet me nivelin e lartë të profesionistëve mjekësor dhe formave të standardizuara të ofrimit të shërbimeve sipas nevojave të pacientëve. Andaj, sfida e ngritjes së cilësisë së sistemit shëndetësor është në varshmëri direkte me përmirësimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional, hartimin dhe aplikimin e protokoleve dhe udhërrëfyesve klinik si dhe me themelimin e strukturave për monitorim dhe evaluim të rregullt të cilësisë së kujdesit shëndetësor. Këto çështje adresohen në PV.

Raportet konfirmojnë që institucionet shëndetësore publike janë mirë të shpërndara në aspektin gjeografik dhe ofrojnë kapacitete të mjaftueshme dhe tëqasshme fizike për të shërbyer popullatën³, duke e përjashtuar Qendrën Emergjente në kuadër të QKUK-së, shërbimet shëndetësore dytësore në Prishtinë dhe qasjen në shërbimet e kujdesit tretësor në veri të Kosovës. Bazuar në këto fakte, prioritetet kryesore janë që deri në vitin 2014 të vendosen parimet dhe standardet themelore, në bazë të të cilave do të planifikohen investimet në të ardhmen (Master Plani, parimet e themelimit të objekteve shëndetësore dhe investimet në pajisje mjekësore), pastaj, të analizohen opcionet dhe fizibiliteti për themelimin e Spitalit Rajonal në Prishtinë si dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore në Qendrën Emergjente në QKUK.

Rrjeti i shërbimeve shëndetësore në Kosovë është i ndarë në sektorin publik dhe privat, të cilat funksionojnë ndaras. Sistemit të shërbimeve shëndetësore gjithashtu i mungojnë rregullat që definojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve shëndetësore parësore, dytësore dhe tretësore, që për pasojë kanë zvogëlimin e dukshëm të mundësive për organizimin formal të sistemit të referimit. Krijimi i standardeve të qarta për përfshirjen e sektorit privat dhe për themelimin e institucioneve shëndetësore publike dhe private, kërkon një sistem funksional të

³ Master Plani i Bankës Botërore

akreditimit, i cili në fakt është parakusht që popullata të përvetësoj secilin institucion shëndetësor si pjesë përbërëse të një sistemi shëndetësor gjithëpërfshirës.

Fondet publike për shëndetësi, si pjesë e GDP-së për kokë banori, kanë shënuar rënie të vazhdueshme gjatë viteve të fundit. Andaj, është sfidë shumë e madhe të sigurohet që burimet ekzistuese njerëzore, fizike dhe ekonomike të organizohen në mënyrë efikase dhe produktive. Mënyra ekzistuese e financimit të institucioneve shëndetësore, nga buxheti, shoqërohet me pagesa kontradiktore⁴ duke mos ofruar lidhshmëri në mes të aktivitetit, cilësisë dhe sasisë së fondeve të marra nga institucionet shëndetësore. Përveç kësaj, menaxhimi i centralizuar i pjesës më të madhe të këtyre fondeve, nuk lejon mundësinë e stimulimit të institucioneve për llogaridhënie. Prandaj, futja graduale e financimit të bazuar në performancë⁵ dhe autonomia e shtuar e institucioneve shëndetësore, së bashku me monitorimin e rregullt të efikasitetit/produktivitetit, do të trasojnë rrugën për zhvillimin gradual të financimit shëndetësor të qëndrueshëm në perspektivën afatgjate. Në këtë kontekst, është jetike që Agjencioni Komisionar për Përkujdesje Shëndetësore (AKPSH) në kuadër të MSH-së të realizoj monitorimin e rregullt të performancës së institucioneve shëndetësore, të lidh kontrata të thjeshta të performancës me spitale dhe të ndërtoj kapacitetet e veta për të administruar me sistemin e pagesës sipas performancës⁶.

Investimet e mëdha në objekte dhe pajisje medicinale gjatë viteve të fundit kanë përmirësuar dukshëm standardin e objekteve shëndetësore. Mirëpo, investimet kanë qenë dhe ende janë duke u bërë pa ndonjë harmonizim me nevojat buxhetore për funksionimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre, duke shkaktuar që p.sh. pajisjet mjekësore të mbesin të pashfrytëzuara. Përveç kësaj, alokimi i barnave dhe furnizimeve mjekësore nuk bëhet në harmoni me shkallën e aktiviteteve të spitaleve. Duke u nisur nga kjo situatë, PV-ja e definon nevojën për zhvillimin e parimeve të reja buxhetore të cilat do të mundësojnë që të krijohet lidhja në mes të kërkesës për shërbime shëndetësore dhe dispozicionit të fondeve, që për rrjedhojë do të ketë përmirësimin e llogaridhënies/autonomisë së institucioneve shëndetësore dhe përmirësimin e mundësive të institucioneve që të gjenerojnë por edhe t'i mbajnë për vehte ato fonde.

Ndryshimet e cekura më lartë janë të nevojshme në mënyrë që sektori i shëndetësisë të bëhet një sistem shëndetësor gjithëpërfshirës dhe i plotë që ofron shërbime cilësore parandaluese, diagnostikuese dhe trajtuese e pastrajtuese që mbulojnë shumicën e nevojave. Këto ndryshime pastaj do të kontribuojnë që popullata të jetë e shëndoshë, e lumtur dhe produktive si dhe e mbrojtur nga rreziqet ekonomike në rastet kur sëmundja është e paevitueshme. Për tu siguruar që ky vizion për sistemin shëndetësor të Kosovës do të arrihet, nevojiten kapacitet të fuqishme udhëheqëse dhe

⁴ Me buxhet të fiksuar, spitalet që ofrojnë shërbime të cilësisë së lartë do të ballafaqohen me kërkesë të madhe dhe prandaj do t'i harxhojnë resurset para se të fillojnë të ofrojnë shërbime të dobëta. Prandaj buxheti i fiksuar ka tendencë që të dënojë cilësinë dhe kërkesën e lartë.

⁵ Gjithashtu njihet edhe si financimi apo kontraktimi i bazuar në stimulim

⁶ Gjithashtu ceket edhe në: Tranzicioni në Shëndetësi dhe Kujdes Shëndetësor në Kosovë; Fatime Arënlju Qosaj dhe Merita Kocinaj Berisha. Shkolla Kosovare e Shëndetit Publik, 2010.

menaxhuese në MSH-së. Në këtë aspekt Raporti i Fridom-it⁷ thotë se: “Lidhur me strukturën e Ministrisë së Shëndetësisë, organizimi aktual në kuptim të praktikave të punës, sistemeve, proceseve, personelit dhe strukturës nuk e mbështet Ministrinë në realizimin e mandatit të saj dhe në ballafaqimin me sfida të konsiderueshme që dalin nga drafti i Planit Strategjik⁸ dhe nga Korniza Afat-mesme e Shpenzimeve”. Prandaj, fuqizimi i kapaciteteve të Ministrisë në kontekstin e organizmit të saj, menaxhimit, planifikimit, qasjes dhe shkëmbimit të informatave, monitorimit dhe ngritjes së shkathtësive janë parakushte, në mënyrë që MSH-ja të jetë në gjendje të marrë përsipër rolin e saj udhëheqës në arritjen e objektivave të SSSH-së që paraqet fushën prioritare të këtij PV.

Krijimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH) elektronik funksional që ofron të dhëna valide dhe me kohë për të gjitha palët në sektorin shëndetësor, është parakusht për përmirësimin e vendim-marrjes së bazuar në dëshmi në të gjitha nivelet. Strategjia e re dhe e finalizuar e Sistemit të Informimit Shëndetësor dhe Plani i Zbatimit (Qershor 2010) paraqet në detaje tri fazat e konceptit dhe hapat praktik të nevojshëm për zbatimin e SISH-it në Kosovë dhe konsiderohet si pjesë përbërëse e këtij PV.

Më 21 Maj 2009 është nënshkruar Marrëveshja e Asistencës së Para-anëtarësimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe BE-së, duke rikonfirmuar përkushtimin e Kosovës për ta ndjekur rrugën drejt anëtarësimit në BE dhe për ta bërë procesin e para-anëtarësimit forcë shtytëse për modernizimin e sektorit publik, përfshirë këtu edhe shëndetësinë. MSH-ja ka inicuar hapin e parë formal duke themeluar Zyren për Integritet Europian. Para-anëtarësimi në BE kërkon që Kosova të dëshmojë ekzistimin e sektorit publik transparent dhe efikas si dhe inkorporimin dhe aplikimin e legjislacionit të BE-së në legjislacionin nacional. Prandaj, është imperativ i kohës të arrihet njohuri e plotë për rregullat dhe normat e BE-së të cilat do të ndikojnë pozitivisht në sektorin e kujdesit shëndetësor, të krijohen mundësitë për llogaritjen e ndikimit financiar të aplikimit të këtyre rregullave, të mirren qëndrime adekuate për atë se si të zbuten efektet negative të anëtarësimit dhe të krijohet sistemi i monitorimit dhe raportimit të progresit të anëtarësimit. BE-ja, përmes instrumentit IPA, ofron mbështetje në procesin e para-anëtarësimit. IPA do të mbështesë vetëm projektet që janë në përputhje me prioritetet kombëtare, prioritetet sektoriale dhe projektet e rëndësishme vitale për procesin e anëtarësimit. Bazuar në këto fakte, PV-ja përqendrohet në zbatimin e atyre veprimeve të cilat janë të nevojshme për përgatitjen e sektorit shëndetësor për anëtarësim në BE.

Monitorimi rigoroz dhe i rregullt dhe raportimi i progresit të zbatimit të SSSH dhe të PV-së, është pjesë integrale e rolit mbikëqyrës të cilin MSH-ja e konsideron kritik jo vetëm për zbatimin e Strategjisë, por edhe për ta sjellë sektorin e shëndetësisë në Kosovë në pozitë prijëse të rajonit. Prandaj, PV-ja përfshinë veprime të pjesëmarrjes aktive dhe të fuqizimit të të gjithë aktorëve të involvuar në shndërrimin e PV-së së SSSH-së në plane vjetore dhe ndërtimin e kapaciteteve për menaxhim strategjik dhe lidhësi si parime udhëheqëse në zbatimin e tij.

⁷ Shqyrtimi Funksional Vertikal i Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës, Qershor 2009, faqe 4

⁸ Strategjia Sektoriale Shëndetësore

4.3. FUSHAT PRIORITARE TË VEPRIMIT

PV-ja është dizajnuar për t'i arritur sfidat kryesore të cekura më lartë përmes zbatimit në tri Fusha Prioritare të Veprimit (FPV), si në vijim:

FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor

FPV 2: Përmirësimi i menaxhmentit dhe lidërshiptit në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor

FPV 3: Zbatimi i suksesshëm i Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë dhe përgatitja e sektorit shëndetësor për para anëtarësim në BE

Përmes kësaj qasjeje të prioritizimit, PV-ja i shndërron pesë Objektivat Strategjike të SSSH-së në tri fusha prioritare të veprimit të dizajnuara për t'u zbatuar përmes një numri të caktuar të rezultateve si në vijim:

Objektivat Strategjike (OS) në SSSH	Fushat prioritare të veprimet (FPV) në PV	Rezultatet e detajizuara në PV
<p>OS 1: Zvogëlimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së përgjithshme të popullatës</p> <p>OS 3: Riorganizimi funksional dhe kompletimi i infrastrukturës ekzistuese</p>	<p>FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor</p>	<p>1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e tij funksionojnë sipas nevojave prioritare të popullatës</p> <p>1.2: Cilësia e shërbimeve shëndetësore e përmirësuar</p> <p>1.3: Niveli i njohurive dhe shkathhtësive mjekësore profesionale i përmirësuar përmes trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm</p> <p>1.4: Barnat dhe materialet esenciale mjekësore të ofruara në bazë të nevojave</p> <p>1.5: Kapacitetet në KPSH - mjekësinë familjare dhe shëndetin e nënës dhe fëmijës të përforcuara</p> <p>1.6: Stili i shëndetshëm i jetës i grupeve më vulnerable të popullatës i përmirësuar</p> <p>1.7: Ngarkesa e sëmundjeve jo-ngjitëse kronike dhe sëmundjeve kërcënuese për jetë e zvogëluar</p> <p>1.8: Ngarkesa e sëmundjeve ngjitëse e zvogëluar</p>
<p>OS 2: Përmirësimi i menaxhimit të resurseve ekzistuese dhe cilësisë së shërbimeve</p> <p>OS 4: Zhvillimi dhe implementimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor</p>	<p>FPV 2: Përmirësimi i menaxhmentit dhe lidhshpimit në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor</p>	<p>2.1: MSH-ja e riorganizuar dhe kapacitetet e saja për t'i udhëhequr zhvillimet në sektorin e shëndetësisë të përparuar</p> <p>2.2: Sistemi formal i planifikimit dhe planifikimit buxhetor i bazuar në nevojat e popullatës i vendosur</p> <p>2.3: Paga e ofruesve të shërbimeve shëndetësore e bazuar në modelin themelor të performancës e prezentuar</p> <p>2.4: Transformimi dhe fuqizimi i autonomisë dhe llogaridhënies së institucioneve shëndetësore publike i zbatuar</p> <p>2.5: Sistemi themelor i Informimit Shëndetësor në Institucionet pilotuese i zhvilluar dhe i zbatuar</p>
<p>OS 5: Zhvillimi i sistemit të qëndrueshëm financiar të sektorit shëndetësor</p>	<p>FPV 3: Zbatimi i suksesshëm i Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë dhe përgatitja e sektorit shëndetësor për para anëtarësim në BE</p>	<p>3.1: Koordinimi i donatorëve funksional dhe sektori shëndetësor i Kosovës i gatshëm për para anëtarësim në BE</p> <p>3.2: Mekanizmat dhe strukturat për monitorim dhe evaluim të zbatimit të SSSH-së, të krijuara dhe funksionale</p>

4.4. Kostoja

Kostoja e vlerësuar e PV-së arrinë në **43,969,484** Euro dhe është prezentuar në pjesën e dytë të dokumentit. Kalkulimi bazohet në modelin e kostimit duke shfrytëzuar çmimin uniform për njësi dhe është i dizajnuar për t'iu përshtatur KASH-it si dhe për tu integruar në procesin e planifikimit vjetor të buxhetit. Në këtë aspekt, PV-ja duhet të shiqohet edhe si mjet për buxhetim strategjik.

Të gjitha vlerësimet e kostos janë bërë në Euro sipas nivelit të çmimeve të vitit 2010.

5. PJESA I: PLANI I VEPRIMIT

5.1. Përmbledhje e Planit të Veprimit për Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2010 - 2014

Rezultatet e detajizuara në PV	Aktivitetet kryesore	Përgj.	Koha
FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor			
1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e tij, funksionojnë sipas nevojave prioritare të popullatës	1.1.1 Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës dhe nevojave për kujdes shëndetësor	MSh /IKShPK	2011
	1.1.2 Analiza e kërkesës për kujdes shëndetësor		2011
	1.1.3 Adoptimi dhe zbatimi i Master planit për Kosovë	MSh	2011
	1.1.4 Sigurimi i resurseve të mjaftueshme për mirëmbajtje dhe zëvendësim të infrastrukturës esenciale dhe teknologjisë mjekësore	/IKShPK MSh MSh	2011-2013
1.2: Cilësia e shërbimeve shëndetësore e përmirësuar	1.2.1 Themelimi i sistemit për sigurimin e cilësisë dhe akreditim të të gjitha institucioneve shëndetësore (në të gjitha nivelet publike dhe private)	MSh	2011
	1.2.2 Monitorimi i rregullt i cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe i kënaqësisë së pacientëve	MSh /IKShPK	2011
	1.2.3 Themelimi dhe sigurimi i mëturjeshëm i përdorimit të protokoleve dhe udhërrëfyesve klinikë për sëmundjet më të shpeshta për tri nivelet e kujdesit shëndetësor	MSh	2011-2014
	1.2.4 Sigurimi i burimeve të mjaftueshme për diagnostikim, trajtim dhe përcjellje cilësore	MSh	2011-2014
	1.2.5 Themelimi i Odës së Profesionistëve Shëndetësore	MSh, FM, ShP	2011-2014
1.3: Niveli i njohurive dhe shkathtësive mjekësore profesionale i përmirësuar përmes trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm	1.3.1 Vlerësimi i nevojave të ardhshme të burimeve njerëzore dhe themelimi i planit edukativ	MSh	2011-2014
	1.3.2 Përmirësimi i sistemit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP)	MSh	2011
	1.3.3 Zhvillimi i kapaciteteve profesionale në politika dhe menaxhment shëndetësor	MSh / MASHT	2011-2014
	1.3.4 Forcimi i kapaciteteve të shërbimeve emergjente në Kosovë	UP MSh	
1.4: Barnat dhe materialet esenciale mjekësore të ofruara në bazë të nevojave	1.4.1 Zbatimi i Planit të Veprimit për barna dhe material mjekësor	MSh	2011-2014
	1.4.2 Zbatimi i softuerit farmaceutik	MSh	
	1.4.3 Depoimi i sigurtë i barërave dhe materialeve medicinale të Listës Esenciale të Barërave të MSH-së	MSh	
1.5: Kapacitetet në KPSH - mjekësinë familjare dhe shëndetin e nënës dhe fëmijës të përforcuara	1.5.1 Përmirësimi i zbatimi të shërbimeve të mjekësisë familjare në të gjitha komunat	MSh	
	1.5.2 Përmirësimi i kujdesit shëndetësor për nënat dhe fëmijët në të gjitha nivelet	MSh MSh	2011-2014
	1.5.3 Përmirësimi i kujdesit shëndetësor nëpër komunitetet më vulnerable	MSh	
1.6: Stili i shëndetshëm i jetës i grupeve më vulnerable i përmirësuar	1.6.1 Promovimi dhe përmirësimi i stilit të shëndetshëm të jetës për grupet e caktuara të popullatës	MSh /IKShPK	
	1.6.2 Zbatimi i ligjit për duhanin dhe Strategjisë për duhanin	MSh	
	1.6.3 Zbatimi i Strategjisë për HIV/AIDS	MSh	
	1.6.4 Promovimi dhe parandalimi i aksidenteve	MSh	2011-2014
	1.6.5 Përmirësimi i gjendjes së shëndetit oral sidomos tek gjeneratat e reja	MSh	
	1.6.6 Zhvillimi dhe zbatimi i Programit kombëtar të	MSh	

Plani i Veprimit 2011 – 2014 i Strategjisë Sektoriale Shëndetësore 2010 -2014

Rezultatet e detajizuara në PV	Aktivitetet kryesore	Përgj.	Koha
	nutricionit		
1.7: Ngarkesa e sëmundjeve jo-ngjitëse kronike dhe sëmundjeve kërcënuese për jetë e zvogëluar	1.7.1 Rritja e njohurive dhe hulumtimeve shkencore në fushën e sëmundjeve kronike dhe atyre jo-ngjitëse 1.7.2 Përmirësimi i zbulimit të hershëm dhe parandalimit të kancerit dhe sëmundjeve kardiovaskulare 1.7.3 Përmirësimi i kapaciteteve të diagnostikimit dhe trajtimit të sëmundjeve malinje dhe atyre kardiovaskulare 1.7.4 Zbatimi Strategjisë për Shëndetin Mendor 1.7.5 Zbatimi i Programit për menaxhimin e plumbit në Komunën e Mitrovicës	MSh /IKShPK MSh /IKShPK MSh	2011-2014
1.8: Ngarkesa e sëmundjeve ngjitëse e zvogëluar	1.8.1 Përmirësimi i vazhdueshëm i programit të zgjeruar të imunizimit 1.8.2 Zbatimi i Programit kombëtar për parandalim dhe kontroll të sëmundjeve ngjitëse	MSh /IKShPK	2011-2014
FPV 2: Përmirësimi i menaxhmentit dhe lidërsipit në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor			
2.1: MSh e riorganizuar dhe kapacitetet e saj për t'i udhëhequr zhvillimet në sektorin shëndetësor të përparuar	2.1.1 Zbatimi i Planit institucional të zhvillimit të MSh-së 2.1.2 Përmirësimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve dhe shkathtësive në MSh për udhëheqjen e procesit të reformave 2.1.3 Vendosja e proceseve dhe kulturës administrative e mbështetur në menaxhimin modern, fuqizimin e stafit dhe llogaridhënien brenda MSh-së	MSh MSh MSh	2011 2011-2012 2011-2014
2.2: Sistemi formal i planifikimit dhe planifikimit buxhetor i bazuar në nevojat e popullatës i vendosur	2.2.1 Elaborimi i buxhetit për institucionet e sektorit shëndetësor bazuar në planifikim, kërkesat për shërbime shëndetësore dhe PV të SSSh-së 2010-2014	MSh	2011-2012
2.3: Pagesa e ofruesve të shërbimeve shëndetësore e bazuar në modelin themelor të performancës e prezentuar	2.3.1 Përforsimi i rolit të Agjencionit për Komisionim e Shërbimeve Shëndetësore të MSh-së 2.3.2 Monitorimi i performancës së institucioneve shëndetësore 2.3.3 Prezentimi i kontraktimit të bazuar në performancë për Institucionet shëndetësore 2.3.4 Zbatimi i Ligjit të aprovuar për sigurime shëndetësore 2.3.5 Rishikimi dhe zbatimi i çmimoreve për shërbime shëndetësore	MSh MSh MSh	2011 2011-2013 2012-2014
2.4: Transformimi dhe fuqizimi i autonomisë dhe llogaridhënies së institucioneve shëndetësore publike i zbatuar	2.4.1 Themelimi i bazës ligjore dhe administrative për transformimin dhe fuqizimin e autonomisë dhe llogaridhënies së institucioneve shëndetësore publike së dhe zbatimi i saj. 2.4.2 Themelimi i kapaciteteve në institucionet shëndetësore për llogaridhënie 2.4.3 Thjeshtimi i çmimoreve për shërbimet shëndetësore	MSh Qeveria MSh MSh	2011-2013 2011-2013 2012-2014
2.5: Sistemi themelor i informimit shëndetësor në Institucionet pilotuese i zhvilluar dhe i zbatuar	2.5.1 Zhvillimi i SISH-it bazik (faza A e Strategjisë së SISH-it) 2.5.2 Pilotimi i suksesshëm i SISH-it dhe përdorimi për politika dhe vendimmarrje të bazuar në dëshmi (faza B e Strategjisë së SISH-it) 2.5.3 Zgjerimi i SISH për mbulim në tërë Kosovën duke përfshirë sektorin privat (faza C e Strategjisë së SISH-it)	MSh MSh MSh	2011-2012 2012-2014 2013-2020

Plani i Veprimit 2011 – 2014 i Strategjisë Sektoriale Shëndetësore 2010 -2014

Rezultatet e detajizuara në PV	Aktivitetet kryesore	Përgj.	Koha
FPV 3: Zbatimi i suksesshëm i Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë dhe përgatitja e sektorit shëndetësor për para anëtarësim në BE			
3.1: Kordinimi i donatorëve funksional dhe sektori shëndetësor i Kosovës i gatshëm për para anëtarësim në BE	3.1.1. Ngritja e kapaciteteve institucionale të MSh-së për bashkëpunim ndërkombëtar dhe kordinim të donatorëve	MSh	2011
	3.1.2 Përgatitja e MSh-së dhe sektorit shëndetësor për para anëtarësim në BE	MSh	2011-2013
3.2: Mekanizmat dhe strukturat për monitorim dhe evaluim të zbatimit të SSSH-së të krijuara dhe funksionale	3.2.1. Monitorimi dhe raportimi i rregullt i zbatimit të PV-SSSh 2010-2014	MSh	2011
	3.2.2 Rishikim afatmesëm i planit të veprimit të SSSH-së 2010-2014	MSh	2011-2014
	3.2.3 Zhvillimi i Strategjisë së re afatmesme për kujdesin shëndetësor (SSSh 2015-2019)	MSh	2013

5.2. FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor

Fusha Prioritare e Veprimit 1 (**FPV1**) përmbledh Objektivën Strategjike të Strategjisë Sektoriale për Shëndetësi nr. 1 (Zvogëlimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së përgjithshme të popullatës), pjesë të përzgjedhura nga Objektiva Strategjike 2 (Përmirësimi i menaxhimit të resurseve ekzistuese dhe cilësisë së shërbimeve) që merret me përmirësimin e cilësisë së kujdesit dhe Objektiva Strategjike 3 (Riorganizimi funksional dhe kompletimi i infrastrukturës ekzistuese) në një prioritet gjithpërfshirës që përqëndrohet në përmirësimin e shërbimeve kyçe shëndetësore, duke theksuar parandalimin dhe duke pasur një ndikim pozitiv në gjendjen shëndetësore të popullatës së Kosovës.

Fusha prioritare e veprimit nr 1. bazohet në arritjen e rezultateve të poshtëshënuara:

REZULTATI 1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e tij funksionojnë sipas nevojave të prioritizuara të popullatës

REZULTATI 1.2: Cilësia e shërbimeve shëndetësore e përmirësuar

REZULTATI 1.3: Niveli i njohurive dhe shkathësisë mjekësore profesionale i përmirësuar përmes trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm

REZULTATI 1.4: Barnat dhe materialet esenciale mjekësore të ofruara në bazë të nevojave

REZULTATI 1.5: Kapacitetet në KPSH – të mjekësisë familjare dhe shëndetit të nënës dhe fëmijës të përforcuara

REZULTATI 1.6: Stili i shëndetshëm i jetës i grupeve më vulnerable të popullatës i përmirësuar

REZULTATI 1.7: Ngarkesa e sëmundjeve jo-ngjitëse kronike dhe sëmundjeve kërcënuese për jetë e zvogëluar

REZULTATI 1.8: Ngarkesa e sëmundjeve ngjitëse e zvogëluar

Objektivat Strategjike 1, 2 dhe 3 në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2010-2014						
FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor						
REZULTATI 1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e saj, funksionon në bazë të nevojave të prioritizuara të popullatës						
<i>Aktivitetet</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Buxheti në Euro</i>	<i>Rreziqet dhe supozimet</i>	<i>Përgjegjës kryesor</i>	<i>Indikatorët e suksesit</i>	<i>Afati kohor</i>
1.1.1 Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës dhe nevojave për kujdes shëndetësor	- Raporti i analizës paraprake, raportet vjetore të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë dhe aktivitetëve të institucioneve shëndetësore -Raportet e analizave të faktorëve të rrezikut ambiental dhe socio-ekonomik	423,400	-Cilësia dhe besueshmëria e të dhënave -Raportimi nga institucionet përgjegjëse	MSH/IKShPK	-Raporti i Analizave	2011
1.1.2 Analiza e kërkesës për kujdes shëndetësor	-Termet e referencës për analizën -Indikatorët për kërkesat e vendosur -Mbledhja e informatave nga institucionet shëndetësore të të gjitha niveleve -Elaborimi i raportit dhe aprovimi -Publikimi	294,660	-Cilësia dhe besueshmëria e të dhënave -Raportim nga institucionet përgjegjëse	MSh/IKShPK	-Raporti i Analizave	2011
1.1.3 Adoptimi dhe implementimi i Master planit shëndetësor për Kosovë	-Rishikimi dhe adoptimi i Master planit -Studimi i fisibilitetit për përmirësimin e kujdesit emergjent në QKUK -Përditësimi i planit të veprimit sipas rezultateve të studimit të fisibilitetit -Rishikimi i statutit të QKUK-së dhe rregulloreve sipas Master planit -Riorganizimi i QKUK-së sipas Statutit të QKUK-së - Studimi i fisibilitetit për Spitalin rajonal të Prishtinës - Studimi i fisibilitetit për Spitalet e Vushtrisë	1,223,520	-Marrëveshje në Qeveri/ Parlament/ Komuna	MSh (Qeveria/ Parlamenti) Komunat MSh/ QKUK/ DKSH	-Vendimi i Qeverisë/ Parlamentit/ komunave -Studimet e aprovuara të fisibilitetit (të gjitha) -Plani i rishikuar i veprimit -Raporti për finalizimin e	2011-2014

Objektivat Strategjike 1, 2 dhe 3 në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2010-2014						
FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor						
REZULTATI 1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e saj, funksionon në bazë të nevojave të prioritizuara të popullatës						
<i>Aktivitetet</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Buxheti në Euro</i>	<i>Rreziqet dhe supozimet</i>	<i>Përgjegjës kryesor</i>	<i>Indikatorët e suksesit</i>	<i>Afati kohor</i>
	dhe të Ferizajit				riorganizimit të QKUK-së	
1.1.4 Sigurimi i resurseve të mjaftueshme për mirëmbajtje, zëvendësim të infrastrukturës dhe teknologji themelore	-Prezentimi i konceptit dhe mjeteve për vlerësim të teknologjisë shëndetësore -Studimi i kostos së mirëmbajtjes dhe ndërrimit/ përtrirjes së pajisjeve dhe rehabilitimit të objekteve -Përmirësimi i bazës ligjore për vendimmarrje për investime që përfshinë edhe ndikimet rekurente buxhetore -Realokimi i buxhetit për investime për mbulim të nevojave për mirëmbajtje dhe zëvendësim të pajisjeve -Plani i investimit i bazuar në master plan, standardet e reja teknike dhe baza e re ligjore	4,835,330	-Rezistenca nga MEF të ndryshojë rregullat për parimet vendim marrese per investime	MSh (në bashkëpunim të plotë me MEF) OBSh	-Korniza ligjore e aprovuar -Plan i ri i adoptuar i investimit -Rialokimi i buxhetit të tanishëm	2011-2014
REZULTATI 1.2: Cilësia e shërbimeve shëndetësore e përmirësuar						
1.2.1 Themelimi i sistemit për sigurimin e cilësisë dhe akreditim të të gjitha institucioneve shëndetësore (në të gjitha nivelet publike	-Studimi për sigurimin e cilësisë, standardeve dhe bazës ligjore në shtetet e krahasueshme -Vendim marrja për politikat zhvillimore për cilësi dhe akreditim -Zhvillimi i bazës ligjore për akreditim -Standardet për akreditim	559,960	-Përfshirja e të gjitha palëve duke përfshirë ofruesit privat të shërbimeve shëndetësore	MSh Komunat	-Institucioni qeveritar për sigurim të cilësisë dhe akreditim i themeluar dhe	2011 – në vazhdim ësi

Objektivat Strategjike 1, 2 dhe 3 në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2010-2014						
FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor						
REZULTATI 1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e saj, funksionon në bazë të nevojave të prioritizuara të popullatës						
<i>Aktivitetet</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Buxheti në Euro</i>	<i>Rreziqet dhe supozimet</i>	<i>Përgjegjës kryesor</i>	<i>Indikatorët e suksesit</i>	<i>Afati kohor</i>
dhe private)	-Krijimi i trupave institucionale për sigurim të cilësisë dhe akreditim -Trajnimet dhe ndërtimi i kapaciteteve të strukturave akredituese				funksional	
1.2.2 Monitorimi i rregullt i cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe i kënaqësisë së pacientëve	-Identifikimi i indikatorëve bazik për cilësi të shërbimeve -Identifikimi i indikatorëve bazik për kënaqësinë e pacientëve - Vendosija e modaliteteve, metodave të mbledhjes të të dhënave, raportimit standard dhe shpërndarjes së tyre -Analiza e rregullt, raportimi dhe informimi kthyes (fed-back) -Auditimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë së shërbimeve - Zhvillimi dhe zbatimi i projektit bazë për siguri të pacientëve	52,580	-Raportim në kohë nga institucionet shëndetësore sipas formatit të vendosur	MSh IKShPK Më vonë institucioni për sigurim të cilësisë dhe akreditim/ Raportet e Auditimit	-Raportim i rregullt -Raporte kthyes të rregullta -Vendim-marrje e rregullt	2011 – në vazhdimësi

Objektivat Strategjike 1, 2 dhe 3 në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2010-2014						
FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor						
REZULTATI 1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e saj, funksionon në bazë të nevojave të prioritizuara të popullatës						
<i>Aktivitetet</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Buxheti në Euro</i>	<i>Rreziqet dhe supozimet</i>	<i>Përgjegjës kryesor</i>	<i>Indikatorët e suksesit</i>	<i>Afati kohor</i>
1.2.3 Themelimi dhe sigurimi i mëtutjeshëm i përdorimit të protokoleve dhe udhërrëfyesve klinik për sëmundjet më të shpeshta për tri nivelet e kujdesit shëndetësor	-Përditësimi i kornizës ligjore për protokolet dhe udhërrëfyesit klinik duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë -Promovimi i kornizës ligjore dhe protokolet e udhërrëfyesit e aprovuar - Monitorimi dhe evaluimi i përdorimit të PUK ekzistuese -Rishikimi i përmabjtjes së PUK ekzistuese - Rishikimi dhe përpilimi i setit të PUK	38,400	-Konsensus në mes të profesionistëve shëndetësor për protokolet dhe udhërrëfyesit klinik -Konsensus mbi monitorim dhe masat për përmirësim të përdorimit të protokoleve dhe udhërrëfyesve klinik	MSh (Inspektorati shëndetësor) IKShPK, Shoqatat profesionale shëndetësore Institucioni për sigurim të cilësisë dhe akreditim	-Protokolet që mbulojnë 20 sëmundjet më të shpeshta të raportuara me përdorim të kënaqshëm në të gjitha nivelet e kujdesit	2011-2014

Objektivat Strategjike 1, 2 dhe 3 në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2010-2014						
FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor						
REZULTATI 1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e saj, funksionon në bazë të nevojave të prioritizuara të popullatës						
<i>Aktivitetet</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Buxheti në Euro</i>	<i>Rreziqet dhe supozimet</i>	<i>Përgjegjës kryesor</i>	<i>Indikatorët e suksesit</i>	<i>Afati kohor</i>
1.2.4 Sigurimi i burimeve të mjaftueshme për diagnostikim, trajtim dhe përcjellje cilësore	-Analiza e koston së kërkuar për diagnostikim bazik cilësor dhe shërbimet trajtuese -Përpilimi i udhërrëfyesve për kategoritë madhore buxhetore të shpenzimeve në spitale -Identifikimi i zonave për fillim të kujdesit ditor, trajtim jashtëspitalor dhe kirurgji ditore -Pilot implementim i kujdesit ditor, trajtimit jashtëspitalor dhe kirurgjisë ditore	224,000	-Konsensus në mes të profesionistëve shëndetësor rreth protokoleve dhe udhërrëfyesve klinik	MSh	-Buxheti i alokuar sipas standardeve minimale -Kujdesi ditor, trajtimi jashtëspitalor dhe kirurgjia ditore të inicuar në spitalet e zgjedhura	2011-2014
1.2.5 Themelimi i Odës së Profesionistëve Shëndetësor	- Përpilimi dhe përfundimi i Ligjit për themelimin e Odës së Profesionistëve Shëndetësorë -Përpilimi dhe miratimi i Statutit të Odës shëndetësore me katër Urdhëra profesional , për mjek, stomatolog, farmacist, dhe infermier, përfshi Termat e Referencës dhe Strukturat organizative të Odës dhe Urdhërave profesionale. -Emërimi i anëtarësisë së Odës dhe Urdhërave. -Përpilimi dhe miratimi i buxhetit për funksionim autonom dhe të vazhdueshëm të	270,000	-Ngadalësia e procedimit të legjislacionit -Mungesa e përvojës -Cënimi i autonomisë së Odës	MSH, Fakulteti i Mjekësisë Institucionet akademike – shkencore. Shoqatat e profesionistëve e shëndetësor Shoqëria civile	-Miratimi i Ligjit -Themelimi i Odës dhe takimet e rregullta të saj dhe Urdhërave të saja. -Themelimi i Sekretariatit të Odës dhe Urdhërave	2012 - 2014

Objektivat Strategjike 1, 2 dhe 3 në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2010-2014						
FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor						
REZULTATI 1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e saj, funksionon në bazë të nevojave të prioritizuara të popullatës						
<i>Aktivitetet</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Buxheti në Euro</i>	<i>Rreziqet dhe supozimet</i>	<i>Përgjegjës kryesor</i>	<i>Indikatorët e suksesit</i>	<i>Afati kohor</i>
	Odës dhe Urdhërave -Themelimi dhe funksionimi i Sekretariatit të Odës dhe Urdhërave					
REZULTATI 1.3: Niveli i njohurive dhe shkathtësive mjekësore profesionale i pëmirësuar përmes trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm						
1.3.1 Vlerësimi i nevojave të ardhshme të burimeve njerëzore dhe themelimi i planit edukativ	-Vlerësimi i nevojave për shkathtësi, njohuri dhe burime njerëzore në shëndetësi, për të gjithë profesionistët -Përpilimi i planit kombëtar të edukimit mjekësor bazuar në nevojat e identifikuar -Fillimi i implementimit të planit kombëtar të edukimit mjekësor në të gjitha nivelet -Përpilimi i edukimit profesional dhe trajnimit në teknikën mjekësore (riparimi dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore)	623,152	-Përfshirje aktive e të gjitha palëve -Vendosmëria nga sektori i arsimit dhe ai shëndetësor	MSh MSh/ MASHT MSh/ MASHT	- Plani kombëtar për zhvillimin e BNj në shëndetësi i aprovuar -Rezultatet e profesionistëve shëndetësor sipas nevojave të planifikuara -Raporte të kënaqshme mbi implementimin e planit kombëtar -Numri i profesionistëve të certifikuar nga institucionet relevante	2011-2014

Objektivat Strategjike 1, 2 dhe 3 në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2010-2014						
FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor						
REZULTATI 1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e saj, funksionon në bazë të nevojave të prioritizuara të popullatës						
<i>Aktivitetet</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Buxheti në Euro</i>	<i>Rreziqet dhe supozimet</i>	<i>Përgjegjës kryesor</i>	<i>Indikatorët e suksesit</i>	<i>Afati kohor</i>
1.3.2 Përmirësimi i sistemit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP)	- Rishqyrtimi i UA 23/2004 për ZHVP -Vlerësimi i nevojave për ZHVP në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor -Rishikimi i planit kombëtar për ZHVP në nivelin e KPSH-së -Reakreditimi i trajnuesve të mjekësisë familjare -Zhvillimi i planit kombëtar të ZHVP -së për nivelin dytësor dhe tretësor -Rilicencimi i profesionistëve mjekësor të të gjitha niveleve bazuar në ZHVP	376,800	- Përfshirje e plotë nga QKUK, SR, QKMF, DKShMS, Shoqatat profesionale	MSh Shoqatat profesionale	-Raportet nga vlerësimi i nevojave të ZHVP-së -Plani kombëtar për ZHVP i aprovuar -Certifikatat e riakreditimit nga RCGP	2011 2011
1.3.3 Zhvillimi i kapaciteteve profesionale në politika dhe menaxhment shëndetësor	- Vendosija e infrastrukturës themelore për ZHVP-se në politika dhe menaxhment shëndetësor -Zhvillimi i Planit të trajnimeve, planprogramit dhe procedurave monitoruese - Zbatimi i ZHVP në politika dhe menaxhment shëndetësor -Aprovimi i Planit të financimit, planit të BNj dhe procedurave administrative për ngritjen e kapaciteteve në menaxhim dhe politika shëndetësore - Organizimi i Studimeve post-diplomike në	908,400	-Përfshirje e plotë nga të gjitha palët e përfshira	MSH, MASHT në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës	-Nr i trajnimeve dhe nr.i stafit shëndetësor dhe jo-shëndetësor të trajnuar në menaxhment dhe politika shëndetësore - Themelimi i Studimeve postdiplomike për menaxhment	2012-2014

Objektivat Strategjike 1, 2 dhe 3 në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2010-2014						
FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor						
REZULTATI 1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e saj, funksionon në bazë të nevojave të prioritizuara të popullatës						
<i>Aktivitetet</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Buxheti në Euro</i>	<i>Rreziqet dhe supozimet</i>	<i>Përgjegjës kryesor</i>	<i>Indikatorët e suksesit</i>	<i>Afati kohor</i>
	menaxhment dhe politika shëndetësore				dhe politika shëndetësore -Nr. i studenteve të regjistruar	
1.3.4 Forcimi i kapaciteteve të shërbimeve emergjente në Kosovë	-Vlerësimi i shërbimeve emergjente në Kosovë -Zhvillimi i kornizës rregullative dhe PUK për shërbimet emergjente në Kosovë -Trajnimi i stafit sipas nevojave -Ofrimi i pajisjeve moderne për shërbimet emergjente -Ngritja dhe integrimi i shërbimeve dispeçerike për shërbimet emergjente në Kosovë	1,440,000	-Përfshirje dhe koordinim i plotë nga të gjitha palët e përfshira	MSh MPB - Policia FSK	-Korniza rregullative -Numri i PUK të aprovuara -Funksionaliteti i qendrës së integruar për shërbime lëvizëse	
REZULTATI 1.4: Barnat dhe materialet esenciale mjekësore të ofruara në bazë të nevojave						
1.4.1 Zbatimi i Planit të Veprimit për barna dhe material mjekësor	- Analizimi i lidhjeve në mes të ofrimit të shërbimeve të secilit institucion shëndetësor dhe nevojës për barna dhe materiale mjekësore - Rishikimi, përditësimi dhe aprovimi i planit të veprimit për barnat dhe materialet tjera esenciale -Analiza të vazhdueshme të MSh-së të stokut të barnave nga lista esenciale e sistemit shëndetësor	784,600	-Rezistencë ndaj decentralizimit të buxhetit -Mungesa e kapaciteteve planifikuese në nivelin e institucioneve	MSh Inspektorati farmaceutik	-Përdorimi i barnave dhe materialeve mjekësore që kanë të bëjnë me performancën e institucioneve shëndetësore -Krijimi i	2011-2014

Objektivat Strategjike 1, 2 dhe 3 në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2010-2014						
FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor						
REZULTATI 1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e saj, funksionon në bazë të nevojave të prioritizuara të popullatës						
<i>Aktivitetet</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Buxheti në Euro</i>	<i>Rreziqet dhe supozimet</i>	<i>Përgjegjës kryesor</i>	<i>Indikatorët e suksesit</i>	<i>Afati kohor</i>
	-Zhvillimi dhe pilotimi i projektit të transferit gradual të përgjegjësiave financiare tek institucionet shëndetësore i kombinuar me prokurimin në nivel qendror - kombëtar për barna dhe material shpenzues nga Lista Esenciale e Barërave				lidhshmërisë në mes përgjegjësiave financiare dhe llogaridhënies për përdorimin e barnave dhe materialeve Mjekësore	
1.4.2 Zbatimi i softuerit farmaceutik	-Zhvillimi i softuerit farmaceutik -Monitorimi dhe raportimi i rregullt rreth stokut të barnave dhe materialeve tjera mjekësore në të gjitha nivelet e kujdesit -Përpilimi i procedurave dhe mekanizmave për shpërndarje -Mekanizmat dhe kanalet e monitorimit dhe evaluimit të shpërndarjes	240,000	-Mungesë e kapaciteteve -Rezistencë e brendshme dhe e jashtme	MSh Inspektorati farmaceutik	-Raportet e rregullta -Raportet farmaceutike nga inspektorati farmaceutik	2011
1.4.3 Depoimi i sigurtë i barërave dhe materialeve medicinale të Listës Esenciale të Barërave të MSH-së	-Ndërtimi i depos qendrore të barërave të MSH-së në QKUK -Sigurimi i kapaciteteve logjistike për distribuim -Trajnimi i stafit	3,000,000	-Mungesa e fondeve -Rezistencë e brendshme dhe e jashtme	MSH	-Dorëzimi i objektit -Vlerësimet e depoimit të sigurtë	2011 - 2012

Objektivat Strategjike 1, 2 dhe 3 në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2010-2014						
FPV 1: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor						
REZULTATI 1.1: Rrjeti i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura e saj, funksionon në bazë të nevojave të prioritizuara të popullatës						
Aktivitetet	Mjetet	Buxheti në Euro	Rreziqet dhe supozimet	Përgjegjës kryesor	Indikatorët e suksesit	Afati kohor
REZULTATI 1.5: Kapacitetet në KPSH - mjekësinë familjare dhe shëndetin e nënës dhe fëmijës të përforcuara						
1.5.1 Përmirësimi i zbatimit të shërbimeve të mjekësisë familjare në të gjitha komunat	-Rishikimi i kornizës ligjore për KPSH -Përditësimi i Strategjisë së KPSH-së dhe planit të veprimit -Implementimi i Strategjisë dhe planit të veprimit të KPSH-së -Fuqizimi i kapaciteteve të QZhMF dhe QEVI	1,280,920	-Korniza ekzistuese ligjore -Strategjia e KPSH-së -Plani i veprimit të Strategjisë së KPSH-së	MSh, Komunat, QZhMF, QEVI	-Numri i mjekëve familjarë të trajnuar -Numri i infermierëve të MF të trajnuar -Korniza ligjore dhe rregullative të nënshkruara	2011-2014
1.5.2 Përmirësimi i kujdesit shëndetësor për nënat dhe fëmijët në të gjitha nivelet	-Përditësimi dhe implementimi i udhërrëfyesve dhe protokoleve për ShNF me fokus në protokolet e referimit të ShNF-së -Ritrajnimi kombëtar në KPSH për ShNF -Ofrimi i pakos bazike të pajisjeve mjekësore për KPSH -Fushatat e promovimit shëndetësor -Sistemi i raportimit perinatal	2,195,920	-Qasja në të dhëna valide -Pjesëmarrje aktive në të gjitha nivelet e kujdesit	MSh, Komunat, IKShPK	-Numri i këshillimeve të kujdesit antenatal në KPSH i rritur për 20% -Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve dhe perinatale e ulur 2% për vit	2011-2014
